



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1572 Prot.

Tiranë, më 22.12 2017

VENDIM Nr. 250, datë 13.12.2017

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë kulturore" (i ndryshuar), Neni 30, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.13, datë 13.12.2017, pasi shqyrtoi Kërkesën për miratim të *projektit "Godinë banimi dhe shërbimesh 1-6 kate me 1 kat nëntokë", me vendndodhje në rrugën "Spiro Puteci", në zonën arkeologjike "B" të qytetit të Durrësit* - subjekti "INRA KONSTRKSION" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Subjekti "INRA KONSTRKSION" sh.p.k., të kontraktojë shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila të paraqesë pranë KKA, *Konceptin e sondazheve arkeologjike* për sheshin e zhvillimit të projektit të sipërpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTRE



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO